

BASHKIA LEZHË

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË
MARRËVESHJEN KUADËR

PËR:

OPERATORI EKONOMIK “MCE” SHPK, ME NUIS L72203065K, ME ADRESE: RRUGA
"KAVAJËS", QENDRA "SUN TOWER", KATI 9, AP.38, TIRANE

OPERATORI EKONOMIK “STUDIO SERVICES K – SA” SHPK, ME NUIS L71305518R, ME
ADRESE: LAGJIA 3, RRUGA “EGNATIA” DHE RRUGA “RAMAZAN JELLA”, PALLATI
1125, KATI I PARË, DURRES

* * *

Procedura e prokurimit: “Procedurë e Pershpejtuar Rindertimi”, E Kufizuar/ Sherbime, Marrëveshje
Kuatër”, me disa operatore ekonomik ku jo te gjitha kushtet jane te percaktuara.

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-96189-05-21-2021

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Sherbimi i mbikqyrjes se punimeve me objekt: Rikonstruksioni i
mjediseve ne bashkepronesi ose te perbashketa ne ndertesat pallat, te prekura nga Termeti i dates
26.11.2019, ne Territorin e Bashkise Lezhe (Loti II).

Kohëzgjatja e Marrëveshjes Kuadër: 12 Muaj nga data e nënshkrimit te marrëveshjes Kuader.

Kohëzgjatja e parashikuar e kontratës: Afati i realizimit te mbikqyrjes se punimeve do te jete i njejte
me afatin e realizimit te punimeve nga shoqeria ndertimore e cila do te zbatoje punimet. Ky
informacion do t’u vihet në dispozicion Operatorëve ekonomik palë të Marrëveshjes Kuadër, gjatë
fazës së dytë të procesit të minikonkurimit.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]
Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: X oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë:

- 1- Operatori Ekonomik “MCE” Shpk, me Nuis L72203065K,
- 2- Operatori Ekonomik “NOVATECH STUDIO” Shpk, me Nuis L01717030C,
- 3- Operatori Ekonomik “STUDIO SERVICES K – SA” Shpk, me Nuis L71305518R,

*Shenim: Ne kete faze te procedurës nuk ju eshte kërkuar Operatoreve Ekonomik, te paraqesin oferte
ekonomike.*

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

- 1- Operatori Ekonomik “NOVATECH STUDIO” Shpk, me Nuis L01717030C,

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

I- Operatori Ekonomik “NOVATECH STUDIO” Shpk, me Nuis L01717030C,

Nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE rezulton se OE:

Se pari, nuk ploteson piken 2.3.5 mbi disponimin e 1 (nje) Inxhinier Mjedisi, ne stafin mbeshtetes, pasi nuk ka paraqitur dokumentacion (diploma dhe kontrata pune) qe provon disponimin e ketij inxhinieri.

Se dyti, nuk ploteson piken 2.3.6 mbi disponimin e 1 (nje) eksperti zjarrefikes ne fushen e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, pasi OE ka paraqitur ne SPE kontrate individuale pune me Z. Naim Baci e lidhur me date 01.17.2020 per nje afat 12 mujor, por nga verifikimi ne listpagesat e shoqerise rezulton se ky punonjes nuk figuron i deklaruar. KVO veren se OE ka shkelur dispozitat e punes ose kontrata e paraqitur eshte fiktive dhe nuk mund te merret parasysh duke mos permbushur kete kriter.

Se treti, nuk ploteson piken 2.3.7 mbi disponimin e certifikates per sistemin e menaxhimit dhe sigurise se shendetit ne pune “BS OHSAS 18001:2007”, pasi nga verifikimi ne SPE rezulton se OE ka paraqitur certefikate BS ISO 39001:2012 per “sistemin e menaxhimit te sigurise ne trafikun rrugor”. KVO veren se ky dokument i paraqitur nga OE nuk ka lidhje me objektin e prokurimit dhe kerkesat e pikes 2.3.7 te DST.

Sa me siper Komisioni i Vleresimit te Ofertave mbeshtetur nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi te refuzoje oferten e OE “NOVATECH STUDIO” Shpk, per mos permbushje te kriterëve te vecanta kualifikuese.

Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, OE “NOVATECH STUDIO” Shpk, me Nuis L01717030C, *skualifikohet*.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm për lidhjen e marrëveshjes kuadër:

- Operatori Ekonomik “MCE” Shpk, me Nuis L72203065K,
- Operatori Ekonomik “STUDIO SERVICES K – SA” Shpk, me Nuis L71305518R

Shënim: Referuar VKM nr.225, datë 12.04.2021 “Për miratimin e dokumenteve standarde të procedurës së prokurimit, të kriterëve të vlerësimit të ofertës fituese kushteve të marrëveshjes kuadër dhe të kontratës për procesin e rindërtimit”, kualifikimi i ofertuesëve në fazën e parë, nuk është me pikë.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë Bashkise Lezhe se bashku me dokumentacioni e noterizuar te ofertes tuaj, brenda 3 (tre) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 04.06.2021

Ankesa: Nuk ka